



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 3.

Prishtinë, më 12.10.2017 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

Munguan: Driton Çausi, Fitore Pacolli, Zenun Pajaziti dhe Glauk Konjufca,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, Blerta Deliu- Kodra, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 3.10.2017;**
- 3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së komisionit për vitin 2017;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 3.10.2017

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së komisionit për vitin 2017

Kryetarja, tha se është hartuar një draft-plan i punës, të cilin do ta shqyrtojmë dhe kërkoj nga anëtarët, që me propozimet dhe sugjerimet e tyre, nëse kanë, të plotësohet dhe ndryshohet për periudhën e mbetur tremujore, për këtë vit.

Andaj, filloj me radhë prej muajit tetor.

Njoftoj se GIZ-i ka paraparë një konferencë prej dt.31 tetor deri më 3 nëntor, ku do të vijë një ekspert nga Kuvendi i Kroacisë, me një ekspertizë rreth MSA-së dhe implementimit të saj në pika konkrete. Ata kanë shfaqur interesim për të na mbështetur në këtë konferencë, ku do të flasim konkretisht për sfidat që i kanë pasur shtetet, të cilat kanë kaluar në agjendën evropiane.

Gjatë muajit tetor kemi paraparë ta ftojmë ministren për Integrim Evropian, që ta shpalosë programin e saj qeverisës dhe pikat kryesore, me të cilat kjo ministri do të punojë gjatë këtij tremujori.

Në muajin nëntor kemi paraparë, që përveç shqyrtimit të projektligjeve nga aspekti i përafrimit me legjislacionin e BE-së, ta ftojmë edhe ministrin e Drejtësisë, ndërsa lidhur me këtë, njoftoi anëtarët për takimin që ka pasur me shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, znj.Natalia Apostolova, ku janë përmendur disa pika shqetësuese që lidhen konkretisht me fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtësisë.

Gjatë muajit nëntor është paraparë që të ftohet në komision, znj. Apostolova.

Në dhjetor kemi paraparë që ta ftojmë për raportim ministrin e Financave, si dhe shqyrtimin e projektbuxhetit të Ministrisë së Integrimit Evropian për vitin 2018.

Lidhur me planin e punës, hapi diskutimin

Ilir Deda, propozoi që pas raundit të parë, pas zgjedhjeve komunale, të ftohet në komision kryetari i Komisionit për shënjimin e vijës kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi dhe gjatë këtij 3 mujori, sa do të zgjasë procesi i demarkacionit, të jemi të kyçur në shkëmbim të ideve dhe mendimeve me z. Bulliqi dhe komisionin e tij të ri.

Në vazhdim, informoi anëtarët që Komisioni i kaluar për Integritet Evropian, njëzëri ka dhënë një udhërrëfyes sesi duhet të duket Ligji për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, i cili është votuar nga Kuvendi dhe kjo komisionit tonë i jap rolin primar mbikëqyrës dhe substancial, sepse korniza e këtij ligji është bërë në legjislaturën e kaluar.

Po ashtu, sugjeroi që nëntor të ftohet ministri për Punë të Brendshme dhe në dhjetor të ftohen 3 ministrat e rinj, që merren me zhvillim ekonomik, sepse po rritet numri i atyre që kanë efekt direkt në zbatimin e MSA-së.

Armend Zemaj, theksoi se duhet kuptuar që jemi në prag të fundit të vitit kalendarik dhe harmonizimi i punëve duhet t'i përshtatet agjendës legjislative dhe detyrave që i ka komisioni.

Mandati kryesor i Kuvendit është mbikëqyrja parlamentare, andaj mendoj se duhet ta rrisim nivelin e mbikëqyrjes parlamentare, por nga propozimet që u dhanë, besoj se ky nivel do të ketë ngritje.

Brenda kësaj periudhe, mendoj se Ligji për përgjimet telekomunikimeve është ligj mjaft i rëndësishëm, Komisioni për Integritet Evropian ka qenë komision funksional, dhe ka pasur një pasqyrë të zbatimit të këtij ligji, i cili është sensitiv dhe është pjesë substanciale dhe kusht për integritet evropian. Po ashtu, do të duhej që para se të vijë projektligji në Kuvend, komisioni të informohet se deri ku ka ardhur zbatimi i këtij ligji,

duke marrë parasysh edhe gjithçka që ndodh në Republikën e Kosovës, sidomos me informacionet, klasifikimin e tyre, verifikimin e tyre, keqpërdorimin dhe shumë gjëra tjera, sepse keni dëgjuar edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, që është një nga çështjet kyçe dhe është në atë minusin që Kosova nuk ka mundur të avancojë, që do të na ndihmonte edhe neve.

Pastaj lidhur me planin e punës, tha se raportimet e ministrave të shndërrohen në mbikëqyrjen e tyre, sepse kur t'i dërgohet ftesa ministrit të Drejtësisë, duhet adresuar saktë se për çka ftohet, pra duhet ditur se cilat ligje lidhen me punën dhe detyrat tona, sipas Raportit të Progresit apo përmbushjes së kriterëve tjera, pastaj me ministrinë e Punëve të Brendshme për luftimin e krimit dhe korrupsionit në vend. Këto dy çështje janë ndër kushtet që duhet të avancojmë për integritet evropiane, si dhe MSA-ja me pikat e veta, përfshirë edhe zhvillimin ekonomik, që është i domosdoshëm. U ndërlihd edhe me diskutimin e parafolësit, ku tha se ne duhet të kyçemi në procesin e mbikëqyrjes së Komisionit për Demarkacion, të shohim se si po shkon nga perspektiva e integriteteve, deri ku ka arritur komisioni i ri, në mënyrë që ne mos të bëhemi pengesë, por të ndihmojmë në këtë proces dhe Kosova të bëhet sa më shpejt pjesë e liberalizimit të vizave dhe integriteteve evropiane.

Milaim Zeka, lidhur me demarkacionin, tha se ka informacione se kushti për demarkacionin nuk ka ardhur nga Brukseli, por ka ardhur nga vetë Kosova dhe këtë duhet të na sqarojë ministria për Integritet Evropian, se kush e ka bërë një propozim të tillë, duke u nisur edhe nga praktikat se asnjë shtet tjetër nuk ka pasur kushte të këtilla, edhe pse të gjitha shtetet e rajonit kanë probleme kufitare. Këtë pyetje do ta bëjë edhe si pyetje parlamentare dhe do t'ia parashtoj edhe para përfaqësueses së BE-së, se kush e solli këtë propozim, sepse do të duhej të ekzistojë ndonjë dokument apo procesverbal, sepse disa zyrtarë të lartë nga Brukseli, më kanë thënë se kushti për demarkacionin ka ardhur nga Prishtina, e jo nga Brukseli. Këtë do ta bëj publike më vonë se kush ma ka thënë.

Në vazhdim, ngriti edhe çështjen e klasifikimit të informacioneve ku kishte vërejtje të mëdha. Më pas, tha se në Kosovë, brenda policisë dhe prokurorëve dhe gjyqësisë, po bëhen gjyqe publike dhe nuk ka kurrfarë klasifikimi të dokumenteve, se çka janë për publikun dhe çka nuk janë. Në të ardhmen, dëshiroj që në kuadër të ligjit, ta ngremë edhe një problem se a klasifikohet si sekret personal dhe si atakim i së drejtës personale, që të drejtën e kontos tënde dhe pasurisë tënde duhet ta dijë shteti, vetëm prokuroria dhe gjyqësia. Nëse prokurorisë apo gjyqësisë i intereson kontoja ime dhe pasuria ime, ata kanë të drejtë të më marrin në pyetje, si deputet dhe të merren me atë çështje, e jo pasuria jonë dhe kontoja jonë të dalë publike, e pastaj Agjencia Kundër Korrupsionit kur të duan ta publikojnë konton, çfarë veture vozitë etj.

Për krejt këto çështje, ne duhet të ndikojmë që t'i fusim në kuadër të sistemit ligjor.

Ahmet Isufi, konsideron se si komision duhet të angazhohemi më tepër në rregullimin e ligjeve për plotësim-ndryshimin e tyre, në mënyrë që Kosova të funksionojë si duhet dhe komisioni këtë detyrë e ka dhe temat të cilat janë më shumë për opinionin, të ngrihen në seanca dhe tubime tjera. Pra, të fokusohemi për tema të caktuara, edhe kur ftohen ministrat, të kemi kujdes mos të bëjmë propagandë, por përkundrazi t'i sqarojmë gjërat në mënyrë të mirëfilltë.

Ilir Deda, kërkoi nga stafi që t'u shpërndahet anëtarëve të komisionit fushëveprimtaria e Komisionit për Integritet. Po ashtu, tha se projektligjet janë pjesë përbërëse e fushëveprimit të komisionit, që është komision kyç që monitoron dhe mbikëqyrë çdo

aspekt të integritimit evropian, në finalizim të këtij plani të punës, duhet t'i planifikojmë disa udhëtime zyrtare, sepse gjithçka që i përket integritimit evropian është automatikisht pjesë e jona.

Kryetarja, theksoi se plani i punës nuk është statik dhe deputetët janë të lirë të propozojnë edhe në ditët në vazhdim, monitorimin e ndonjë ligji apo në fushat specifike, që i konsiderojmë me interes për qytetarët e Kosovës.

Armend Zemaj, propozoi që të futet në plan të punës, gjithsesi, monitorimi i zbatimit të Ligjit për përgjimet e telekomunikimeve, sepse një plan i punës nuk konsiderohet i kompletuar, nëse nuk përfshihet gjatë vitit kalendarik mbikëqyrja e zbatimit të së paku dy ligjeve që janë në fuqi. Kjo është pjesë kryesore e mandatit të komisionit, sepse në hartim të legjislacionit, ky komision është shumë periferik, në raport me komisionet tjera.

Në vazhdim, kërkoi nga kryetarja e komisionit që pavarësisht raportit të komisionit, pozitë apo opozitë, që çdo informacion që vjen në emër të komisionit, t'u shpërndahet anëtarëve të komisionit, që të jemi në kontinuitet me zhvillimet.

Kryetarja hodhi në votim planin e punës, me propozimet e bëra nga anëtarët. Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet draft-planin i punës së Komisionit për Integritet Evropian, me propozimet e bëra.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë, **Kryetarja** njoftoi komisionin për takimin që e kishte pasur me znj. Natalia Apostolova, në kuadër të takimeve që kishte me kryetarët e komisioneve, për të biseduar për agjendën evropiane. Në fillim të takimit, ajo kishte rikonfirmuar se Komisioni për Integritet vazhdon të jetë angazhimi i saj konkret dhe do të gëzojë mbështetjen e fuqishme, sepse agjenda evropiane do të jetë një prej prioritetëve të këtij legjislativi, prej pikave kryesore dhe fokusi kryesor i BE-së do të jetë sundimi i ligjit, ku janë përmendur ligjet që janë me interes, që ne si komision duhet t'i trajtojmë, siç janë: Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, Kodi penal dhe si shqetësim është ngritur edhe numri i madh i agjencive në Republikën e Kosovës, po ashtu është kërkuar që me një marrëveshje mes Qeveris dhe Kuvendit, në mënyrë që të dihet numri i saktë i tyre, sa janë funksionale, sepse në Raportin e Progresit, vazhdimisht është raportuar për rritjen enorme brenda institucioneve dhe për nepotizmin. Gjithashtu, është kërkuar reformimi i administratës publike dhe me theks të veçantë një kategorizim i shërbyesve civilë. Ne, në 3 mandate, kemi kërkuar që të bëhet Ligji për pagat e shërbyesve civilë, por në takim u tha se nuk mund të ketë ligj, pa pasur një kategorizim të pagave të shërbyesve civilë. Po ashtu, na u tha që pa plotësuar dy kriteret e mbetura nuk mund të ketë liberalizim të vizave. Pra, është mirë që ne ta ftojme në komision, z. Shpejtum Bulliqi, për të diskutuar se ku jemi në këtë drejtim, gjithashtu u tha se në procesin e zgjerimit është evidentuar që shumë shtete që pretendojnë të jenë anëtare të BE-së, kanë pasur probleme në demarkacionin e kufijve, prandaj Kosovës i është vendosur kriteri i demarkacionit me Malin e Zi.

U propozua që në takimet e radhës të flitet hapur edhe për MSA-në dhe cilat do të jenë objektivat e këtij Kuvendi, në implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Armend Zemaj, tha se dua ta kuptoj drejt kryetaren e komisionit, kur e përmendi Ligjin për konfiskimin e pasurisë në mënyrë të paligjshme, por pasi që nuk është paraparë në agjendën legjislative dhe Qeveria nuk e ka prioritet këtë ligj, por nëse është menduar që bashkërisht ta nisim një iniciativë të tillë ligjore, është diçka tjetër dhe e kam vullnetin, qoftë për ndryshimin e ligjit që ka të bëjë me zgjerimin e kompetencave, sepse nuk e kemi një ligj ekzakt që flet për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Është dashur që të bëhet presion në Qeveri, që ta sjellë një ligj të tillë, por në këtë tremujor nuk besoj se do ta sjellin, sepse mungon një analizë e saktë.

Ilir Deda, diskutoi lidhur me përbërjen e Komisionit të Kuvendit për MSA-në. Ai tha se ky problem ishte edhe në mandatin e kaluar, duke i marrë parasysh praktikën e Ballkanit Perëndimor, komisioni kishte rekomanduar që Komisioni për MSA-në të përbëhet prej anëtarëve të komisioneve, të cilat e mbikëqyrin zbatimin e MSA-së. Kryesia e Kuvendit kishte vendosur, në mandatin e kaluar, që përbërja e këtij komisioni të jetë në mospërputhje me punën e Kuvendit. Mendoj që edhe tani Kryesia do të vendosë jashtë rekomandimeve tona. Andaj, kërkoj nga Komisioni që sa më shpejt që është e mundur, së bashku të kërkojnë një takim me Kryetarin e Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë, për t'ua shpjeguar, pse duhet pasur koherencë midis komisioneve parlamentare, të cilat e mbikëqyrin MSA-në dhe komisionin e përbashkët të Parlamentit Evropian të shtetit të Kosovës. Nëse ne nuk arrijmë ta realizojmë këtë, do të ketë dy raportime të ndryshme dhe 2 mbikëqyrje të ndryshme dhe mos ta bëjmë gabimin e njëjtë si në mandatin e kaluar, sepse atëherë prapë dalim të vetmit në rajon, me këtë përbërje.

Ne patëm propozuar që edhe në Rregullore të Kuvendit të përcaktohet kjo çështje, e cila në mënyrë të njëanshme, pastaj është hequr. Ne kemi punuar bashkërisht në Rregulloren e re ku është edhe kodi i etikës, i riu, andaj ne duhet që të jemi shumë më të zëshëm, bashkë në këtë dhe mos të lejojmë çalim institucional dhe të ecim përpara me rregullore të re dhe të kthehen ato propozime, të cilat i kemi dhënë në të gjitha komisionet në Kuvend, që të kemi një rregullore të mirëfilltë që i rregullon përgjegjësitë e komisioneve parlamentare dhe i fuqizon ato, ashtu si kërkohet në procesin e integriteteve evropiane.

Armend Zemaj, tha se është shumë e saktë ajo që tha parafolësi, por tani jemi në mes asaj që Kryesia e ka miratuar një rregullore për atë komision, që ka qenë në mandatin e kaluar, por tani duhet ta autorizojmë vetëm kryetaren e komisionit të bisedojë me Kryetarin e Kuvendit, e jo të gjithë anëtarët. Nga informacionet që kam tani, ka ndryshuar ajo logjikë dhe tani propozimet do të shkojnë nga Komisioni për Integritet dhe Komisioni për Punë të Jashtme, do të ishte mirë që edhe në mbledhje të Kryesisë, por edhe në grupet tona parlamentare, që të diskutojmë, sepse nevoja e koherencës është shumë e domosdoshme.

Kryetarja, tha se ne do të vendosim bashkërisht, nëse e shihni të arsyeshme, të kemi një takim të veçantë me Kryetarin e Kuvendit dhe me shefat e grupeve parlamentare, lidhur me përbërjen e Komisionit të MSA-së dhe shefat e grupeve parlamentare kanë qasje të drejtpërdrejtë të diskutojnë lidhur me përbërjen e këtij komisioni, por nga informacionet që kam, Komisioni për Integritet dhe Komisioni për Punë të Jashtme, do

të jenë pjesë kyçe e përbërjes së trupit të Kuvendit, lidhur me zbatimin e MSA-së, por Kryesia do të vendosë se cila do të jetë përbërja dhe kush do ta udhëheqë atë komision.

Ilir Deda, theksoi se është prapë gabim, nëse në përbërjen e Komisionit të MSA-së, nuk përfshihet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Punë të Brendshme, që janë kyç për MSA-në. Ne duhet që anëtarëve të Kryesisë t'i u sqarojmë dhe informojmë se si shkon kjo fushë, njëjtë si e kanë vendet tjera.

Ahmeti Isufi, mendon se kjo është pasojë e së kaluarës, sepse kompetencat e Kryesisë dhe komisioneve nuk janë sqaruar sa duhet, se cilat janë obligimet dhe rolet e tyre, por përkundrazi janë konfuze, duke marrë të dyja obligime dhe pa u komunikuar me mes veti dhe pa e ditur agjendën, qoftë me Këshillin e Evropës, qoftë me NATO-n, që kanë qenë të përfaqësuara gjithmonë nga ana e Kryesisë dhe komisionet kanë qenë të panjoftuara ose kanë bërë agjendë të dyfishtë, e që e ka dëmtuar komunikimin. Në vendet tjera, është më ndryshe, p.sh. ata i kanë disa këshilla, që në fakt shefi i grupit parlamentar është anëtar i Kryesisë ose kryetar i komisionit, në mënyrë që pastaj kur ndahen kompetencat dihet kush prezanton dhe kush është përgjegjësi. Ky dualizëm e ka dëmtuar komunikimin, andaj do të ishte mirë që në të ardhmen, kryetarja e Komisionit për Integritet dhe shërbimet e grupeve që janë, në mbledhje të Kryesisë ta paraqesin si problem, për hir të komunikimit më të mirë dhe më të drejtë.

Milaim Zeka, tha se si pikë referimi duhet ta marrim eksperiencën kroate, sepse nëse merren nga shtetet e rajonit, do të dalë rezultati shumë i keq, sepse të gjitha jemi vende problematike. Në vazhdim, u ndërlidh edhe me diskutimin e kryetares lidhur me reformën në administratën publike dhe me kategorizimin e shërbësve civilë, të kërkuar nga BE-ja. Ne jemi vend i vogël, por partitë politike të mëdha, deri më tani, kanë funksionuar si shoqëri aksionare për punësimin e njerëzve, kanë punësuar njerëz me lista, kryesisht para zgjedhjeve, në televizion, postë dhe në të gjitha institucionet. Pra, këtë dukuri, ne duhet ta luftojmë në të ardhmen. Kjo është problem për BE-në, sepse është shkatërrimi i administratës publike, komplet administrata është jofunksionale. Te çështja e demarkacionit, tha se kisha pasur dëshirë që ne si Komision për Integritet Evropian, në takime me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, ta parapërgatitim një opinion, sepse qysh tash e di finalen se çka do të ndodhë me komisionin e riemëruar rreth çështjes së demarkacionit. Pra, t'i themi bashkësisë ndërkombëtare se në qoftë se Qeveria dhe Kuvendi do t'ia delegojnë Gjykatës së Arbitrazhit, të paktën ta heqin si kusht.

Në vazhdim, iu drejtua kryetares dhe deputetit Zemaj për një këshillë juridike. Ai tha se do të dëshironte të marrë një iniciativë për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit rreth privilegjeve marramendëse që kanë Kryesia e Kuvendit. Si ka mundësi që çdo anëtar i Kryesisë t'i kushtojë buxhetit 6 mijë €, ka xhip, shofer, këshilltar dhe asistente, andaj kërkoj ta di vetëm në çfarë mënyre mund të marrim iniciativën, ne si deputetë, për të ndryshuar këtë.

Kryetarja, ia dha fjalën deputetit Zemaj, i cili është marrë me rregullore e punës së Kuvendit dhe është më kompetent, sepse ka qenë i involvuar në këtë proces.

Armend Zemaj, theksoi se ne faktikisht mund të marrim çdo iniciativë ligjore prej 6 deputetëve, mirëpo Rregullorja, me Kushtetutë i kërkon 2/3 e deputetëve të Kuvendit.

Ne kemi konsideruar se ka qenë një prej rregulloreve më të avancuara. Sipas Kushtetutës, Kryesia e Kuvendit është trup administrativ, këta e kanë shndërruar gjithmonë në politike, sepse ka qenë interes më i ngushtë, kurse po të ishte administrative, do të merrej me menaxhimin e Kuvendit dhe do të eliminoheshin shumë defekte të cilat po përsëriten dhe po dëgjohen me të drejtë apo edhe ndonjëherë po ekzagjeronen.

Në demokracitë parlamentare dhe parlamentet funksionale, janë grupet parlamentare që vendosin për politikën e Kuvendit, pavarësisht këtyre gjërave është një disiplinë fiskale që është krijuar kohëve të fundit në Kuvend në menaxhimin e parasë publike, si nga komisionet dhe trupat tjerë. Edhe për mua ka qenë shqetësues numri i madh i këshilltarëve që sillen. Arsyeja ka qenë, sepse disa paguhen nga institucionet që e mbështesin Kuvendin e Kosovës, por edhe sot e kësaj dite paga e një këshilltari është sa paga e deputetit.

Ilir Deda, ndërhyri dhe tha se këshilltarët pagën bazë e kanë më të madhe se deputetët, kurse nëpër media thuhet se ne paguhemi më së shumti, që nuk është e vërtetë. Ne duhet të insistojmë që edhe nëpër komuna t'u rriten rrogat drejtorëve dhe shërbyesve civilë.

Armend Zemaj, shtoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të merret me nivelimin e pagave, brenda institucionit të Kuvendit.

Milaim Zeka, theksoi se jam optimist, sepse në Kuvend ka deputetë të rinj, që janë të pa- djallëzuar dhe kemi mundësi t'i ndryshojmë disa gjëra, nëse kemi vullnet. Pra, kam menduar për këtë iniciativë, së pari do ta bëjë publike, sepse kam fakte se çdo anëtar i Kryesisë, buxhetit të Kosovës i kushton 6 mijë €.

Anëtarët e komisionit e konsideruan se derisa nuk miratohet Ligji për nivelimin e pagave, kjo iniciativë tani nuk mund të realizohet.

Në fund të mbledhjes, **kryetarja** kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të dakordohen për caktimin e ditës dhe orës, se kur do ta mbajnë mbledhjen gjatë javës.

Kryetarja konstatoi se komisioni u pajtua që mbledhjet e Komisionit për Integritet Evropiane, të mbahen të martën, prej orës 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra